



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 28, Datë 29.01.2021

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGETA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 15/2 prot., datë 26.01.2021 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “AGETA” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 260, datë 28.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AGETA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje me “Njoftimin për Licencim” nr. 62/47 prot., datë 29.12.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “AGETA” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 32 prot., datë 11.01.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “AGETA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 32/1 prot., datë 18.01.2021, 32/2 prot., datë 25.01.2021 dhe 32/3 prot., datë

26.01.2021, ka paraqitur dokumentacionin e munguar i cili është pasqyruar në pjesët takuese të këtij relacioni.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencën e tregtimit të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “d”, “e”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal., Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “AGETA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI